

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
EJTORIA E ADMINISTRATËS DHË PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Klase / Izlaze / Date / Dana: 02.05.2024		
Urgj. / Urg. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 32	Nr. Faqeve. / Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 32  
Data: 30.04.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024 miratoi këtë:

### VENDIM

## PËR DALJE NË KOSULTIM PUBLIK TË STATUTIT AKTUAL TË QKMF-SË TË VITIT 2016 SI DHE DRAFT STATUTIT UNIK TË QKMF-SË TË ADAPTUAR ME SPECIFIKA TË QKMF-SË FERIZAJ

### I

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr.78/24 i datës 08.04.2024 për dalje në konsultim publik të Statutit aktual të QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft Statutit Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së Ferizaj.

### II

Vëhet në konsultim publik Statuti aktual i QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft Statuti Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së Ferizaj.

### III

Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqitën ditën e konsultimit publik, i cili do të caktohet në afatet e parapara ligjore, dhe njoftimi për konsultim publik do të paraqitet në veb faqen e komunës.

### IV

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë si dhe Kryetari i Komunës.

### V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

  
Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA  
Ishese / Izlazne: Date / Dana: 02/05/2024  
Nr. Orgv. / Org. jed: 01 Nr. Prot. / Br. Prot.: 33 Nr. Faqeve. / Br. Strana: 1  
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 33  
Data: 30.04.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024 miratoi këtë:

**VENDIM  
PËR THEMELIMIN E FORUMIT TË PANELIT PËR TRANSPARENÇË KOMUNALE  
FERIZAJ**

**I**

Forumi ka këtë përbërje:

1. Arbnore Salihu (PDK);
2. Adnan Selmani (LVV);
3. Besim Haziri (LDK);
4. Zekir Bytyqi (AAK);

**II**

Ky forum ka për qëllim ngritjen e nivelit të transparencës, llogaridhënien, pjesmarrjen dhe gjithë përfshirjen e qytetarëve për të kontribuar në përmirësimin dhe fuqizimin e qeverisjes në komunën tonë.

**III**

Përbërja e anëtarëve të këtij vendimi mund të ndryshohet, varësisht nga nevojat e Komunës.


**IV**

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Kryetari i Komunës.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

  
Xhavit Zariqi



REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Dalese / Izlaze. Date / Dana: 02, 04, 2024

Nr. Orgv. Org. jed: 01 Nr. Prot. Br. Prot.: 34 Nr. Faqeve. Br. Strana: 4

Ferizaj - Uroševac



REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 34  
Data: 30.04.2024

Organizata jonë buxhetore (656) Komuna e Ferizajt, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194 dhe me Ligji Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024, Neni 9 pika 7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë Vitit 2023 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për Vitin 2023, barten në Vitin 2024 me Vendim të Kuvendit të Komunës.

Mjete për bartje të të hyrave vetanake kemi nga Viti 2023 në Vitin 2024 si tejkalim të të hyrave kemi shumën prej 1,269,634.92€ të cilat kemi propozuar që t'i shpërndajmë në kategoritë ekonomike: Subvencione, Investime kapitale dhe shpenzime komunale.

Bartja e mjeteve vetanake si tejkalim i planit të inkasimit të THV të Vitit 2023 për bartje në shumën prej 1,269,634.92€.

Mjetet e pa shpenzuara të Vitit 2023 dhe vitit paraparak janë shpërndarë në kategoritë ekonomike: Mallra dhe Shërbime, Subvencione, Shpenzime komunale dhe investime kapitale. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024 mori këtë:

**VENDIM  
PËR BARTJEN E MJETEVE TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2023  
NË VITIN 2024**

**I**

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr: 01.Nr.90/24 i datës 24.04.2024 për bartjen e mjeteve të hyrave vetanake nga Viti 2023 në Vitin 2024.

**II**

Bartja e mjeteve vetanake si tejkalim i Planit të inkasimit të THV të Vitit 2023 për bartje në shumën prej 1,269,634.92€.

### III

#### Kategoritë Ekonomike

1. Shpenzime Komunale.....	149,634.92€
2. Subvencione.....	750,000.00€
3. Kapitale.....	370,000.00 €

**Gjithsej mjete për bartje..... 1,269,634.92€**

#### SHPENZIME KOMUNALE

##### Programi;

Administrata e përgjithshme (16332) 149,634.92€

**I Gjithsej: 149,634.92€**

#### SUBVENCIONE

##### Programi;

Shërbimet Publike (18032) 200,000.00€

Administrata e Shëndetësisë (73041) 100,000.00€

Administrata e Arsimit (92160) 450,000.00€

**II Gjithsej 750,000.00€**

## INVESTIME KAPITALE

### Programi;

Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93930) 50,000.00€

Arsimi i mesëm i Lartë (95130) 170,000.00€

### Programi:

Shërbime Publike-Infrastruktura rrugore(18032) 150,000.00€

**III Gjithsej: 370,000.00€**

**Totali I+II+III = 1,269,634.92€**

### Projektet kapitale

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e mjeteve për bartje
1	49853	Ndërtimi i shkolles se re në Neredime	50,000.00 €
2	44149	Ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj	170,000.00 €
3	53023	Ndërtimi i objektit II për nevoja të komunës në Fshatin Gërlicë, Ferizaj	150,000.00€
<b>TOTAL</b>			<b>370,000.00 €</b>

**IV**

Për realizimin e këti vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave si dhe Kryetari i Komunës.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

**Komuna Ferizaj**

Datë	<b>30.04.2024</b>
Për	Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes	Udhëheqësi i zyrës, Zyrtari për Punë të Kuvendit
Nga	Kryesuesi i KK Xhavit Zariqi
Lënda	Lista e akteve

Bashkangjitur po ju përcjellim tabelën e aktit si dhe numrin e votave që ka marr në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt për mbledhjen e mbajtur më **30.04.2024**

Nr	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	<b>VENDIM PËR DALJE NË KOSULTIM PUBLIK TË STATUTIT AKTUAL TË QKMF-SË TË VITIT 2016 SI DHE DRAFT STATUTIT UNIK TË QKMF-SË TË ADAPTUAR ME SPECIFIKA TË QKMF-SË FERIZAJ</b>	34	0	0	<b>01.Nr. 32</b>
2	<b>VENDIM PËR THEMELIMIN E FORUMIT TË PANELIT PËR TRANSPARENÇË KOMUNALE FERIZAJ</b>	34	0	0	<b>01.Nr. 33</b>
3	<b>VENDIM PËR BARJTEN E MJETEVE TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2023 NË VITIN 2024</b>	34	0	0	<b>01.Nr. 34</b>